



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.10.2017
Referencë	11-344/9
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-SHTATOR



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin – SHTATOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivndime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të pajegjistruara dhe pa pranime teknike	Mali i pa përshtatshëm për konsum	
Biznesit	266	18	11			33	12		26				0	30	123					15		
Ambientit	192	25		1		4			73						88			1				
Bujqësisë	451	5				56			13						198			6	173			
Ndërtimtarisë	35	11							23					1								
Trafikut	269	21				46			29			98		8	29			38				
Sanitar	154	10		2	27	7			77	3					14		14					327€
Gjithsejtë	<u>1367</u>	<u>90</u>	<u>11</u>	<u>3</u>	<u>27</u>	<u>146</u>	<u>2</u>		<u>241</u>	<u>3</u>		<u>98</u>	<u>8</u>	<u>39</u>	<u>452</u>		<u>14</u>	<u>45</u>	<u>173</u>	<u>15</u>	<u>327€</u>	

Gjatë muajit Qershor kemi hasur në biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjë regjistrimin e tyre pran qëndrese së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan. Gjithashtu kemi pasur biznese pa pëlqim nga inspektorët e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor, ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek inspektorët e tregut. Në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko minimale për të ushtruar veprimtarin e tyre biznese, po ashtu kemi pasur ankesa të konsumatorëve ku gjatë blerjes kanë hasur në parregullsi të bizneseve.

Gjatë muajit shtator janë mbyllur 2 objekte biznese për arsyeje të shkeljeve ligjore.

Gjatë muajit në një aksion së bashku me Policinë e Kosovës në rr."Bajram Gashi" kemi bërë inspektimin e transportuesve të ndryshëm ushqimorë ku në njërin prej tyre është gjetur mall me afat të skaduar i cili është asgjësuar në vend dhe ndaj kompanisë është bërë një kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje (Fletëparaqitje). Në bazë të ankesës së një konsumatori i cili në një market kishte blerë djathë dhe nga produkti i njëjtë kemi marrë mostra për analiza dhe në bazë të rezultateve të analizave të bëra produkti i tillë ka rezultuar i pa përshtatshëm për konsum dhe është bërë asgjësimi i tij, ku vlera e mallit të asgjësuar është 315 € dhe po ashtu ndaj kompanisë është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

Në muajin Shtator është bërë inspektimi-kontrollimi i kompanive të autobusëve dhe auto-taksit, ku janë kontrolluar edhe parkingjet e auto-taksive në rrugët e qytetit se mos po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale. Në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë në bashkëpunim me policinë kufitare, kemi inspektuar edhe kompanitë e autobusëve për rende të udhëtimit të cilët operojnë në qytetin e Lipjanit, kemi bërë edhe inspektimin e tregjeve si tregu i gjelbër, kafshëve dhe i mobileve.

Gjatë këtij muaji janë bërë inspektime mbi tokat Bujqësore në regjionin perëndimor të Komunës ku janë fokusuar ndërrim-destinimet e tokës Bujqësore, është inspektuar edhe regjioni lindor i Komunës sonë mbi ndërrim destinimin e tokave Bujqësore janë inspektuar Barnatoret Bujqësore mbi dokumentacionin përkatës për importim dhe distribuim të farërave dhe plehrave pasi që jemi në sezonin e mbjelljeve vjeshtore sipas ligjeve përkatëse

Gjatë muajit Shtator janë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi dhe inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonën urbanistike dhe zonat jo urbane. Objekte pa leje ndërtimi gjatë këtij muaji nuk është identifikuar asnjë objekt. Të gjitha inspektimet e realizuara gjatë këtij muaji në objektet e ndërtimit rezultojnë të pajisura me leje ndërtimore, konform Ligjit të ndërtimit.